L I G J
Nr.8037, datë 22.11.1995

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7802, DATË 2.3.1994 "PËR PAGAT E KRYETARIT DHE TË ZËVENDËSKRYETARIT TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 41/a të ligjit nr.7596, datë 31.8.1991 "Për një shtesë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 11 të ligjit nr.7597, datë 31.8.1992 "Për shërbimin e Kontrollit të Shtetit",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

1. Në nenin 1 të ligjit nr.7802, datë 2.3.1994 "Për pagat e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Ngarkohet Këshilli i Ministrave të bëjë indeksimin e pagës së kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit sa herë që bëhen ndryshime në pagë për punëmarrësit në institucionet buxhetore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 1 maj 1995.

Shpallur me dekretin nr.1304, datë 29.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha